

NJOFTIM PËR SHTYP

Botues: DIHA – Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri

Data: 15.06.2022

Kontakt: DIHA, +355 (0) 4 222 71 46, info@diha.al

Pas një viti pandemie, sfida e radhës për bizneset është largimi i fuqisë punëtore.

Shqipëria nuk do të jetë edhe për shumë kohë vendi “ku mund të bësh biznes me paga të ulëta”.

Rezultatet e anketimit vjetor të Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) për klimën e biznesit dhe investimeve në Shqipëri

Në anketimin mbi klimën e biznesit, i cili u plotësua nga kompanitë anëtare të DIHA-s në periudhën prill-maj 2022, **situata aktuale ekonomike vlerësohet negativisht nga 42% e të anketuarve** dhe duket të jetë më pozitive në krahasim me një vit më parë (2021: 63%). 18% e të anketuarve e vlerësojnë me “mirë” situatën ekonomike, ndërkohë që vitin e kaluar ishin vetëm 8% e tyre. 39% e kompanive e vlerësojnë situatën ekonomike si “të kënaqshme” (2021: 29%).

21% e të anketuarve vlerësojnë pritshmëritë për situatën ekonomike më mirë, ndërkohë që vitin e kaluar këtë vlerësim e kishin 23% e bizneseve. 44% e kompanive vlerësojnë si të „pandryshuar“ pritshmëritë për situatën ekonomike (2021: 38%), ndërsa 36% e tyre e vlerësojnë negativisht (2021: 40%).

Pasi kanë kaluar 2 vite të vështirë pandemie, bizneset **shprehen më optimistë për situatën e ekonomisë shqiptare në përgjithësi dhe të sektorit të tyre**. Nga ana tjetër, **pritshmëritë mbi të ardhurat e biznesit** kanë pësuar rënie.

36% e të anketuarve vlerësojnë situatën për vetë biznesin më mirë, ndërkohë që vitin e kaluar këtë vlerësim e kishin vetëm 25% e bizneseve. 46% e kompanive vlerësojnë si të „pandryshuar“ situatën e tyre (2021: 35%), ndërsa 18% e tyre e vlerësojnë negativisht (2021: 40%).

Ndër faktorët, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e një destinacioni investimesh, janë vlerësuar më mirë **produktiviteti dhe motivimi i punonjësve, kualifikimi i punonjësve dhe kostoja e punës**. Një ndryshim pozitiv dallohet edhe tek faktorët që më parë shiheshin në mënyrë shumë kritike, si “Barra Tatimore”, “Sistemi dhe administrata tatimore”, “Stabiliteti politik dhe social” dhe “Siguria ligjore”. Ndërsa faktorët “Disponueshmëria dhe cilësia e furnitorëve lokalë” dhe “Disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar” shënojnë një rënie të dukshme në krahasim me një vit më parë.

Në përgjigje të pyetjes “Ku i shikoni rreziqet më të mëdha në zhvillimin ekonomik të kompanisë suaj në 12 muajt e ardhshëm?”, duke u nisur edhe nga zhvillimet e fundit, pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen se **“Çmimet e energjisë dhe të lëndëve të para”** është rreziku më i madh për biznesin. Më pas **“Mungesa e forcës së punës”** dhe **“Kostoja e punës”** përmenden ndër risqet kryesore.

Pyetjes “Si e shihni zhvillimin e tregut të punës në Shqipëri?” 73% e të anketuarve i janë përgjigjur se intensiteti i emigrimit do të rritet, 18% vlerësojnë se volumi aktual i emigrimit do të ulet në një të ardhme të afërt. 4,5% argumentojnë se puna e kualifikuar do të shoqërohet me rritje pagash, ndërsa 4,5% argumentojnë se do të jetë i lartë qarkullimi i punonjësve. Me sa duket, shkalla e lartë e emigrimit po e bën gjithnjë e më të vështirë gjetjen e forcave të punës, aq më pak me kosto të ulëta.

Presidentja e DIHA-s, znj. Stephanie Sieg-Farka u shpreh në fjalën e saj përshëndetëse se pandemia ka shkaktuar humbje të mëdha për disa kompani dhe disa prej tyre madje u është dashur të mbyllin veprimtarinë e tyre. Është e kuptueshme që ekonomia nuk mund të rimëkëmbet menjëherë, veçanërisht pas sfidave dhe vështirësive të reja që i sjell ekonomisë lufta në Ukrainë. Megjithatë ajo theksoi se perspektivat e biznesit për të ardhmen janë përmirësuar nga viti i kaluar, por emigracioni i fuqisë punëtore po shkakton vështirësi.

Ambasadori Gjerman, z. Peter Zingraf theksoi në fjalën e tij se “Lufta ruse në Ukrainë ka tronditur të gjithë botën dhe efektet e saj janë ndjerë pothuajse kudo. Rritja e kostove, veçanërisht për energjinë, përbën një tjetër sfidë për kompanitë. Gjermania ka ndihmuar dhe do të ndihmojë në zbutjen e ndikimit ekonomik, qoftë nëpërmjet ndihmës direkte pas tërmetit; mbështetjen e SME-ve të prekura nga pandemia përmes një strukture këshillimore dhe skemave të garancisë; ose nëpërmjet bashkëpunimit tonë me qeverinë në reformimin e sektorit të energjisë. Lufta ndaj korrupsionit, shteti i së drejtës dhe transparencës mbeten qendrore nëse ne duam të shfrytëzojmë tërësisht potencialin e marrëdhënieve ekonomike gjermano-shqiptare. Ato janë vendimtare për klimën e përgjithshme të investimeve, për zhvillimin ekonomik të vendit si dhe për procesin e integritimit evropian. Sikurse e dini, në këtë rrugëtim ju mund të besoni në mbështetjen e plotë të Gjermanisë”.

Mbi anketimin

Nga data 29 mars deri më 22 prill 2022, Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri, së bashku me 16 Dhoma Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) në **Rajonin e Europës Qendrore dhe Juglindore (EQJL)**, realizoi me kompanitë anëtare anketimin vjetor mbi klimën e biznesit dhe investimeve në Shqipëri. Nga të gjitha zyrat (AHK) të rajonit EQJL morën pjesë në këtë anketim **983 kompani**, nga të cilat **33 ishin nga Shqipëria**. Kjo korrespondon me një pjesëmarrje prej 43 % të kompanive anëtare të DIHA-s. Pjesëmarrësit marrin pjesë në këtë anketim online dhe përgjigjet analizohen në mënyrë anonime. Tematika dhe gama e pyetjeve është për të gjitha vendet njësoj.

Rreth Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA)

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) është një shoqatë e pavarur, e krijuar nga kompani të ndryshme në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në Tiranë.

DIHA përfaqëson interesat e biznesit gjerman në Shqipëri. Ajo nxit marrëdhëniet bilaterale të biznesit dhe këshillon kompanitë gjermane dhe shqiptare në lidhje me bashkëpunime të mundshme dhe kërkime tregu. DIHA është e lidhur me rrjetin e Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK). AHK ka në të gjitha vendet, të cilat janë me interes për ekonominë gjermane. Deri më tani numërohen 92 shtete me mbi 140 zyra përfaqësie në të gjithë botën (www.ahk.de).